

URDHËR
Nr. 256, datë 10.4.2020

PËR DISA SHTESA DHE NRYSHIME NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020,
“PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:

“1. Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00–17:30, duke filluar nga dita e hënë, datë 13.4.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Hyrja në aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri lejohet vetëm për një person, të autorizuar, për çdo familje, për kryerjen e shpenzimeve familjare ditore. Autorizimi do të jetë vetëm një herë në ditë dhe do të ketë një afat prej 90 minutash, gjatë fashës orare 05:00 deri në 17:30.

Hyrja në të gjitha dyqanet/njësitet tregtare që lejohet të hapen duhet të bëhet me radhë, duke ruajtur distancën e sigurisë prej 1.5 m nga njëri-tjetri. Çdo dyqan/njësi tregtare duhet të sigurojë maska dhe doreza për punonjësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe solucion dezinfektues për të gjithë personat që hyjnë në ambientet e dyqanit/njësitisë tregtare.”.

3. Pika 2 riformulohet si vijon:

“2. Kufizimin e lëvizjes, në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësorë, biçikleta, ciklomotorë, motomjete dhe mjete) si dhe ndalimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga aktivitetet e lejuara, çdo fundjavë, duke filluar nga e premtja ora 17:30 deri të hënë në orën 05:00. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitet kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike, si dhe shërbimet në banesë (*delivery*).”

4. Fjalja e parë, e pikës 3, riformulohet si vijon:

“Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1, dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga e premtja, datë 17.4.2020 e në vijim, nga ora 17:30 deri të hënë në orën 05:00, deri në një urdhër të dytë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu